

SYLLABUS i Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E drejta kadastrale
Niveli:	Bachelor (studime themelore)
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Semestri III
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Prishtinë
Mësimdhënësi i lëndës:	1. Prof. Asoc. Dr. Haxhi Gashi, 2. Prof. Ass. Dr. Sc. Qerkin Berisha
Detajet kontaktuese:	haxhi.gashi@uni-pr.edu; qerkin.berisha@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	<p>Problemet pronësore janë njëra ndër problemet më të ndërlikuara në Kosovë si në aspektin e drejtës, regjistrimit të drejtave në Kadaster ashtu edhe në aspektin e të bërë biznes. Çdo transaksion biznesor në një mënyrë ose tjetrën ka të bëjë me atë që e quajmë “Pronësi ose Pasuri”, ose të drejtat tjera sendore me përjashtim të rasteve kur objekt i transaksionit është ndonjë veprim (shërbim). Andaj, për çdo juristi i cili pritet të specializohet në fushën juridike civile, njohurit për të drejtën e pronësisë janë të domosdoshme. Megjithatë, mënyra e regjistrimit të të Drejtave Pronësore në Kadaster është një çështje mjaft me rëndësi sepse pa regjistrimin e të drejtave në Kadaster si : të drejtës së pronësisë, servituteve, hipotekave, të drejtës së ndërtimit barrëve sendore e drejta nuk krijohet. Gjithashtu, regjistrat në kadaster dhe mënyra e funksionimit janë të domosdoshme për njohurit e një juristi.</p> <p>Kursi përfshinë shqyrtimin analitik të drejtës së pronësisë dhe të drejtave tjera sendore (Pronësisë, servituteve, hipotekës, pengut, të drejtës së ndërtimit dhe të barrëve sendore) me vështrim për mënyrën e regjistrimit në kadaster. Ky kurs do përqendrohet në shqyrtimin e çështjeve themelore që kanë të bëjnë me Funksionimin e Kadastrit në Kosovë, Regjistrave Kadastrale dhe Regjistrin për regjistrimin e të drejtave në paluajtshmeri. Gjithashtu do të shqyrtohen edhe efektet e regjistrimi i të drejtat tjera sendore, oragnizimi i Kadastrit, parimet e funksionimit, Rregullimi teknik dhe juridik i Kadastrit, etj</p> <p>Përmes këtij kursi synohet të merren njohurit themelore</p>

	për të drejtën kadastrale në Kosovë.		
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është ofrimi i njohurive ligjore dhe praktike për studentët në atë mënyrë se si të kuptohen më mirë 1) dispozitat ligjore me të cilat rregullohet e drejta e pronësisë dhe të drejtat tjera sendore dhe 2) regjistrimi i të drejtave sendore, 30 Funksionimi i Sistemit Kadastral në Kosovë dhe regjistrave kadastral etj. Përmes këtij kursi synohet që studentët të përgatiten me njohuri të nevojshme për zbatimin e tyre në praktikë.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të aftësohen për kryerjen e veprimeve si në vijim: <ol style="list-style-type: none"> 1. Të kuptoj nocionet dhe institutet e të drejtës së pronësisë dhe të drejtave tjera sendore si: servituteve, hipotekës, pengut, të drejtës së ndërtimit dhe barrëve sendore. 2. Të marrin njohuri për funksionimin e Kadastrit dhe mënyren e regjistrimit të drejtave sendore në Kadaster. 3. Të jenë në gjendje për interpretimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore nga fusha e të drejtës pronësore; 4. Të jenë në gjendje të kryen punë praktike në institucione të ndryshme të ndërlidhura me çështjet të regjistrimit të drejtave pronësore në Kadaster dhe të specializohen për veprimtari si: gjykata themelore, komerciale, arbitrazhe, institucione financiare etj. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	1/15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	1/15	15
Punë praktike	1	1/15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	1/15	15
Ushtrime në teren	1	1/15	15
Kollokfiume,seminare	2	2/5	10

Detyra të shtëpisë	2	1/5	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	1/15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	2	1/5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	5	1/1	5
Projektet,prezentimet ,etj	10	1/1	10
Totali	5 ECTS	Total	150

Metodologjia e mësimdhënies:

Kursi do të organizohet përmes ligjëratave, seminareve dhe shqyrtimin e rasteve

Ligjëratat: mbajtja e ligjëratave do të bëhet në forme gojore e përcjell me power point, interaktive – bashkëbisedim me studentët, diskutim i çështjeve praktike

Seminaret: çdo studentë duhet të punoj një punë kërkimore-shkencore që do të prezantohet përmes seminarit. Seminari duhet të jetë në mes 8 dhe 10 faqe, formati A4, formati i shkronjave fonti- time new roman, madhësia 12, hapësira 1.5. Çdo seminar duhet të ketë temën e trajtimit e cila formohet në formë të hipotezës apo pyetjes së hapur e cila duhet ta gjejë përgjigjen e qartë në përmbajtjen e seminarit me theks të veçantë në konkluzion. Tema e seminarit caktohet në konsultim me profesorin. Seminari duhet të përbëjë një punë të pavarur shkencore dhe e shoqëruar me referenca (fushnotë) të qarta dhe çdo kopjim ose plagjiaturë, do të reflektohet me vlerësim negativ në vlerësimin përfundimtar.

Raste studimi-simulimi: gjatë kursit studentët do të kenë punë praktike të cilat do të jenë në formën e rasteve të studimit që mbahen në klasë. Studentët do të ngarkohen edhe me raste studimi të cilat duhet të punohen në si detyrë shtëpie dhe të sjellën te profesori në kohën e kërkuar. Rastet e studimit përbëhen nga formulime me shkrim të rasteve nga praktika dhe dhënia për detyrë studentëve për të zgjidhur rastin e tillë në pajtim me dispozitat ligjore. *Simulimi* i rasteve paraqet formë praktike përmes së cilës studentët aftësohen në ushtrime praktike duke simuluar raste dhe marrë rolin e palëve dhe organeve tjera në kontestet pronësore.

<p>Metodat e vlerësimit:</p>	<p><u>Obligimet e studentit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Vijimi i Ligjëratave • Pjesëmarrje ne ushtrime • Pjesëmarrje aktive, diskutimet • Punime seminarike, projekte, • Pjesëmarrje ne teste dhe ushtrime, • Puna individuale dhe grupore ne raste studimi, • Provimi përfundimtar. <p><u>Mënyra e vlerësimit të studentit (në %):</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i parë: 30% • Vlerësimi i dytë 25% • Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% • Vijimi i rregullt 5% • Provimi final 30% <p><u>Ndërtimi i notës:</u></p> <table border="0" style="width: 100%;"> <tr> <td style="width: 50%; vertical-align: top;"> <ul style="list-style-type: none"> • <u>%</u> • 91-100 • 81-90 • 71-80 • 61-70 • 51-60 </td> <td style="width: 50%; vertical-align: top;"> <ul style="list-style-type: none"> • <u>Nota</u> • 10 (dhjetë) • 9 (nëntë) • 8 (tetë) • 7 (shtatë) • 6 (gjashtë) </td> </tr> </table>	<ul style="list-style-type: none"> • <u>%</u> • 91-100 • 81-90 • 71-80 • 61-70 • 51-60 	<ul style="list-style-type: none"> • <u>Nota</u> • 10 (dhjetë) • 9 (nëntë) • 8 (tetë) • 7 (shtatë) • 6 (gjashtë)
<ul style="list-style-type: none"> • <u>%</u> • 91-100 • 81-90 • 71-80 • 61-70 • 51-60 	<ul style="list-style-type: none"> • <u>Nota</u> • 10 (dhjetë) • 9 (nëntë) • 8 (tetë) • 7 (shtatë) • 6 (gjashtë) 		
Literatura			
<p>Literatura bazë:</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Abdulla Aliu, “E drejta sendore (pronësia)”, Prishtinë, 2014, faqe 17-56, 427- 466. - Haxhi Gashi, “Fitimi dhe humbja e pronësisë sipas ligjit për pronësinë dhe të drejta tjera sendore: Influenca e Kodit Civil Gjerman-BGB në Ligjin e Kosovës”, publikuar në Konferencën ndërkombëtare për legjislacionin pronësor dhe reformën e tij në Kosovë dhe regjion, Prishtinë 28-29 qershor 2010, Botuar në Revistën E drejta, nr. 1, 2013. - Haxhi Gashi- Pjesë të caktuara të ligjëratave për sistemin Kadastral në Kosovë, 2014. 		
<p>Literatura shtesë:</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ejup Statovci, “Marrëdhëniet pronësoro-juridike në sendet e paluajtshme në KSA të Kosovës”. Prishtinë, 1977, Ribotim 2009 - Ejup Statovci, “Pronësia, origjina dhe zhvillimi (studim komparativ)”. Prishtinë, 1983, Ribotim 2009 		

	<ul style="list-style-type: none"> - Elizabeth Cook (eds.), “Modern Studies in Property Law”, Vol. 4, Oxford, 2007 - Francesco Galgano, “E drejta private I (pronësia)”, Luarasi, Tiranë, 2003 <p>LIGJE:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, Gazetën Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 57/2009 date 4 Gusht 2009. - Ligji nr 2002/5 mbi themelimin e regjistrimit të të drejtave në pronën e paluajtshme, i ndryshuar me Ligjin nr. 2003/13., me ndryshime në vitin 2011 - Ligji nr. 2003/25, për kadastrin, i ndryshuar me Ligjin nr. 02/L-96 dhe ndryshimet në vitin 2011.
--	---

Plani i dizajnuar i mësimit:

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	- Hyrje, prezantimi i lëndës
<i>Java e dytë:</i>	- Kuptimi i të drejtave sendore
<i>Java e tretë:</i>	- Bazat ligjore që rregullojnë të drejtat sendore - Parimet e të drejtës sendore
<i>Java e katërt:</i>	- Kuptimi i Kadastrit
<i>Java e pestë:</i>	- Organizimi i Kadastrit
<i>Java e gjashtë:</i>	- Bazat Ligjore për funksionimin e sistemit Kadastral
<i>Java e shtatë:</i>	- Llojet e regjistrave Kadastral
<i>Java e tetë:</i>	- Mënyra e regjistrimit të drejtave në regjistrin për regjistrimin e të drejtave në paluajtshmëri
<i>Java e nëntë:</i>	- Regjistrat teknik të Kadastrit
<i>Java e dhjetë:</i>	- Regjistrimi i një të drejte të pronësisë
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	- Regjistrimi i një Servituti
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	- Regjistrimi i një Hipoteke
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	- Regjistrimi i një të Drejte Ndërtimi
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	- Regjistrimi i një Barre Sendore
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	- Diskutime, përmbledhje, dhe evaluimi i kursit

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Rregullat disiplinore dhe Integriteti akademik:

- a) Gjatë vijimit të kursit duhet të ruhet integriteti personal dhe akademik i mësimit dhe studentit
- b) Pjesëmarrja e studentëve është e detyrueshme (çdo mungesë e paarsyeshme reflektohet në vlerësimin përfundimtar)

- c) Studentët duhet ti përmbushin detyrimet e dhëna gjatë punës praktike dhe detyrimeve të shtëpisë. Mungesa e përmbushjes së detyrimeve reflektohet në kalueshmërinë e provimit.
- d) Studentët duhet ti përmbahen rregullave disiplinore të mbarëvajtjes së ligjëratave, ushtrimeve dhe provimit.
- e) Plagjiatura dhe format e ndryshme të kopjimit janë të ndaluara dhe reflektohen në vlerësimin negativ për studentin dhe ndëshkime tjera sipas rregullave përkatëse ligjore.